

ANALIZA VJETORE

2014

(Mbi aktivitetin e administrates se Bashkise për vitin 2014)

Shkurt 2015

Te nderuar pjesemarrës !

Analiza e hapur qe zhvillojme sot, ka si objekt, te trajtoje aspektet kryesore te punes dhe aktivitetit te administrates se Bashkise Lezhe per vitin 2014, te evidentojte arritjet, te analizoje problematiken qe eshte hasur dhe te identifikojte shkaqet me qellim permiresimin e gjithanshem te punes dhe performances se Bashkise ne sherbim te qytetareve.

Gjithashtu do t'u njohim me disa nga objektivat me te rendesishme te administrates, per vitin 2015, si vit i fundit i mandatit zgjedhor 2011-2015 :

Nder trajtesat me kryesore do evidentojme:

- a. Realizimin e detyrave dhe objektiveve te parashikura, per vitin 2014 ne permiresimin e sherbimeve ndaj komunitetit, si nje nga prioritetet e qeverisjes vendore te Bashkise;
- b. Cili ka qene progresi ne hartimin dhe zbatimin e projekteve te zhvillimit ne infrastrukturen publike, gjithnje ne funksion te rritjes se cilesise se jetes se qytetareve.
- c. Evidentimi i mangesive te konstatuara ne praktiken e punes se administrates, me problematiken qe eshte perballur ajo gjate vitit 2014.
- d. Ne fund te kesaj analize do te njihemi me disa nga objektivat me te rendesishme, per vitin 2015 te cilet perkojne me vitin e fundit te mandatit katervjeçar te qeverisjes vendore.

Te nderuar pjesemarrës !

Viti 2014, ka qene një vit i rendesishem, ne kujtesen e popullit shqiptar dhe banoreve e qytetit tone pasi Ai:

- Ishte viti Jubilar i 70 vjetorit te çlirimit te atdheut dhe veprimtarite perkujtimore, kulturore e historike kishin vlerësim e investim te veçante;
- Ishte vit i rritjes se cilesise se sherbimit ndaj komunitetit, per krijimin e besueshmerise ndaj institucionit tone dhe Lidërshiptit,
- ishte viti i vazhdimit te projekteve te filluara me pare, ne disa segmente te infrastruktures se qytetit, me finacime nga te ardhurat e Bashkise dhe kredia bankare;
- ishte viti i fillimit te projekteve madhore qe po zbatohen ne infrastrukturen publike te qytetit, per te evidentuar vlerat e medha te Lezhes, si nje qytet, me trashegimi historike, kulturore dhe arkeologjike, per ta bere qytetin me atraktiv dhe terheqes, per vizitore vendas dhe te huaj.
- Ishte vit i cili formatoj administraten me statusin e nepunesit civil, si nje strukture afatgjate dhe e pavarur nga politika dhe ndryshimet e saj;

- Ishte vit intensiv, me mjaft pune, arritje dhe veshtiresi, per realizimin e objektivave ekonomike te parashikuara;
- Ishte vit ku politika sociale mbeshteti me mire se asnje vit tjetër shtresen ne nevoje, duke akorduar nje fond prej 123,8 milion leke, per ndihmen ekonomike dhe paaftesine, ose rreth 13 % me shume se nje vit me pare.
- gjithashtu viti 2014 ishte edhe vit mosrealizimi, ne aspektin e te ardhurave vendore, si pasoje e krizes ekonomike globale me e dukshme kjo ne industrine e ndertimit, efektet e se ciles ndikuan ndjeshem ne buxhetin e Bashkise.

Viti 2014 te cilin kemi lene mbrapa, vlen te arkivohet ne kujtesen tone jo vetem si vit jubilar, por si nje vit ne te cilin moren jete dhe po zbatohen shume projekte ne sherbim te qytetarit, duke filluar nga Projekti I Qeverisjes Elektronike, si nder projektet me prioritare dhe bashkekohore te realizuara deri tani, per te vijuar ne projektet madhore ne infrastrukturen publike ne qendren e qytetit, periferine e tij, ndertimin e rikonstruksionin e institucioneve te shkollimit dhe edukimit, nder te cilet evidentojme:

1. Ne **bashkefinancim me dldp** kemi realizuar nje projekt ne vleren 5 milion leke, per akomodimin dhe vendosjen e sistemit te qeverisjes elektronike ne Zyren me Nje Ndalese (One Stop Shop).
2. Nga te **ardhurat e Bashkise** jane realizuar kater projekte ne infrastrukturen publike si:
 - a. Sistemimi dhe asfaltimi rruges tek Stacioni Trenit (faze e pare);
 - b. Sistemimi i bllokut banimit, pas shtepise Ushatarakeve (faze pare)
 - c. Sistemimi e asfaltimi I rruges “Ing. Gjadri” lagje “Skenderbeg”;
 - d. Pastrimi dhe sistemimi kanali ujrave te larta (lagje Varosh).



3. Me **kredine e Bankes** (Intesa Sanpaolo) jane financuar 4 projekte ne vleren **51,3 milion** leke, te filluara vite me pare si:
- a. Sistemim asfaltim rruga lagje “Nene Tereza”;



- b. Dy projekte ne sistemim asfaltim dhe ndriçim i rruges ne bllokun 11,2 ha lagje “Beslidhja” (para Katedrales & Gjmnazit)



c. Sistemim asfaltim rruge lagje “Gurra”;

4. Me **Grantet e Zhvillimit Rajoneve** Qeveria Shqiptare ka financuar gjashte projekte ne vleren 295 milion leke, nder te cilet jane:
 - a. “Ndriçimi dhe sistemimi i rruges hyrëse te Lezhës, segmenti Ura Drinit - Rotondo” - **Vlera 42 milion leke (ne proces).**



Foto nga gjendja egzistuese

Sipas projektit



Rolanda ne hyrje te qytetit



Foto nga gjendja egzistuese

Sipas projektit



Rrethrotullimi prane lumit Drin

*b. Rikualifikim i sheshit te qendres "Beslidhja" me fond **60. milion** leke;*



*c. Rikualifikim i sheshit "Gjergj Kastrioti" me fond **101 milion** leke*



d. Rikualifikimi rruges dhe lulishtes para memorialit te “Skenderbeut”,
“Rruga e Poeteve” me fond **28 milion leke**;



e. Rikonstruksin i ures se lumit Drin“ me fond **27 milion leke**.



f. Rikualifikim i lulishtes ne qender te qytetit me fonnr **31 milion** leke



5. Me nje financim prej **49 milion leke** te **Ministrise Arsimit** filloj puna ne tre objekte te arsimit si:
 - a. Ndertimi Kopshtit me ushqim lagje Beslidhja (Faze pare) me vlere rreth **28,3 milion** leke.



b. Ndertimi dy qendrave sportive me vlere **20,5 milion** leke (faze prokurimi)



6. **Ministria Zhvillimit Urban**, ka financuar dy projekte me vleren 25,5 milion leke, nder te cilet jane, projekti rritjes se eficences se energjise ne :
- a. Rikonstruksioni i pallatit sheshi Beslidhja“ me vlere **14 milion** leke;



- b. "Rikonstrukcioni 36 banesave komunitet "Rom - Egjptian" me vleren **11,5 milion leke**



7. Ministria e Mjedisit ka financuar projektin:

- a. Pastrim dhe sistemim i bregut lumit Drinit me vlere **35,5 milion** leke,



8. Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka financuar dy projekte me vleren 85 milion

- a. Ndertimi I rruges lagje “Nene Tereza” **78 milion** leke



b. Rikonstruksioni I Ures vjeter mbi lumin Drin rreth 7 milion leke



9. Me financimin prej 25 milion leke nga nje donator Italian – Agimi – Bolsano, po realizohet:

a. Rikonstruksioni dhe paisja e shkolles “Gj. Fishta” ne vleren rreth 180 mije euro (rreth 25 milion leke);



Pra, viti 2014 me gjithë veshtiresite e tij ekonomike, mund të konsiderohet si viti i zbatimit të projekteve të mëdha të zhvillimit, gjatë së cilit morën jetë dhe filluan nga puna 22 projekte në infrastrukturën publike, në përmirësimin e mjedisit dhe ndërtimin e rikonstruksionit të institucioneve të arsimit.

Ndërsa në aspekte të tjera të qeverisjes vendore evidentojmë :

1. Eshtë realizuar – hartimi i strategjisë së Zhvillimit Ekonomik 2013-2030 dhe botimi i saj në dy gjuhë (anglisht-Shqip);
2. *Përmirësimin e* ndjeshëm të shërbimit ndaj komunitetit, në evidentimin i kërkesave dhe ankesave, regjistrimi në mënyrë dixhitale dhe shkurtimi në kohë i dhenjes së përgjigjes.
3. Gjatë vitit, janë kryer një sërë shërbimesh ndaj komunitetit si:
 - a. Të pritur vetëm nga Kryetari Bashkisë rreth 1050 qytetarë, nga pritja zyrtare dhe aktivitet e hapura.
 - b. Janë dhënë rreth 2258 vertetime me shkrim kërkuar nga qytetarë;
 - c. Janë hapur rreth 440 dosje të reja për biznesi;
 - d. Nga sportelet e QKR-së janë kryer rreth 3400 shërbime ndaj biznesit;
 - e. Janë trajtuar me ndihmë ekonomike mesatarisht 500 familje në nevojë dhe asistuar nga ana financiare rreth 1090 persona etj;

Pra, siç evidentuam me sipër gjatë vitit 2014, u shënuan arritje të vecanta në dy aspekte të qeverisjes vendore:

Se pari : Në aspektin e hartimit të projekteve të zhvillimit dhe financimit të tyre duke siguruar mbështetjen e Qeverisë Shqiptare, ministrive dhe donatoreve të tjerë, për t'i ndryshuar pamjen qytetit dhe përmirësuar cilësinë e jetës së banorëve të tij dhe;

Se dyti: Janë shënuar arritje cilësore në shërbimin ndaj komunitetit qytetar ku me të drejtë mund të quhet një shërbim, i një modeli të ri dhe bashkëkohor.

Ky shërbim cilesor erdhi si rrjedhojë e implementimit të projektit të Zyres me një Ndalese (One Stop Shop), për një qeverisje elektronike.

Në këto zyra u përmirësuan ndjeshëm kushtet e pritjes, akomodimi i vizitorëve, marrja e problematikës, ndjekja e kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, kthimi i përgjigjeve në kohë, etj.

Gjithashtu, e vecanta e këtij projekti për vitin 2014 ka qenë Instalimi i moduleve: kerkese-ankese, ndihma ekonomike dhe libraria ligjore. Ky projekt ka mundësuar dixhitalizimin e të gjitha praktikave shkruese hyrëse në administratë, dhenja e përgjigjeve ndaj shtetasve dhe institucioneve.

Por, nëse në shërbimin ndaj qytetarëve, kemi shënuar arritjen më të madhe në shtatë vitet e fundit, dhe janë vënë në rrugën e zgjidhjes shumë projekte zhvillimi, në investimet publike etj., në realizimin e të ardhurave vendore në dy vitet e fundit kemi patur mosrealizime të dukshme. Ky është një tregues real, i ndikimit të krizës globale e cila ka shtrirë efektin e saj si në gjithë vendin edhe në Bashki, ndonëse vlerësimi i situatës dhe tendenca për të minimizuar ndikimin e kësaj krize, ka qenë objekt i rëndësishëm në punën e punonjësve të sektorit të të ardhurave dhe atij të financave për rritur efikasitetin e përdorimit të buxhetit.

Cilet kanë qenë objeksionet kryesore të punonjësve të administratës, për vitin 2014:

Administrata e Bashkisë dhe institucionet vartës gjatë vitit 2014, ka funksionuar me një strukturë të përbërë nga 9 drejtori, 4 zyra, 7 institucione vartëse dhe një sektor i shërbimeve publike.

Veprimtaria e punonjësve të Bashkisë, për vitin 2014 ka synuar në realizimin e objektivave të parashikuara që në fillim të vitit, punë të cilën do të përpiqemi ta e vërtetojmë nëpërmjet kësaj analize dhe konkretisht:

DREJTORIA E TË ARDHURAVE VENDORE:

Ka synuar :

1. Në evidentimin e vazhdueshëm dhe menaxhimin e subjekteve të tatueshme;
2. Ndjekjen e liçensimit të biznesit të vogël e të mesëm;
3. Përditësimin e databasës të të gjitha subjekteve tregtare që ushtrojnë aktivitetin e tyre të regjistruara në organet tatimore;
4. Ushtrimin e kontrolleve në rrjetin e biznesit, me objekt realizimin e të ardhurave fiskale, të planifikuara për vitin 2014.

Siç theksuam edhe me lart, viti 2014 ka qene jo i suksesshen, ne re realizimin e te ardhurave vendore. Faktoret qe ndikuan ne mosrealizime, kane qene shume planesh, si subjektive dhe objektive.

Nder aresyet subjektive qe ndikuan ne mosrealizimin e te ardhurave evidentojme:

- a. mungesa e pergjegjesise se punonjesve te ketij sektori &
- b. moskordinimi institucional me agjentet tatimor jashte bashkise.

Nder faktoret objektiv te mosrealizimit te te ardhurave evidentojme:

- a. niveli financiar jo i mire i sektorit te biznesit,
- b. mungesa e trojeve per ndertim, renja e tregut te banesave, paaftesia paguese e industrise se ndertimit dhe nderprerja e lejeve te ndertimit, solli si pasoje mosrealizimin e takses se ndikimit ne infrastrukture e cila ze rreth 26,8 % te te ardhura vjetore.

Nga te dhenat perfundimtare japin kete pasqyre ne realizimin vjetor te te ardhurave:

Te ardhurat ne pergjithesi u realizuan ne masen **93.187 mije leke ose 45,37 %**, ndaj planifikimit.

Te ardhurat tatimore jane realizuar ne masen 52.193.000 ose 42 %

Te ardhurat jo tatimore jane realizuar ne masen 40.994.000 ose 50.46 %

Krahasuar me vitin 2013 kemi kete pasqyre:

| Lloji te ardhurave | 2013 | | | 2014 | | |
|--------------------|----------------|---------------|------|----------------|---------------|--------------|
| | Pl. | Fakt | % | Pl. | Fakt | % |
| Tatimore | 131.306 | 57.645 | 42,9 | 124.115 | 52.193 | 42 |
| Jotatimore | 92.180 | 41.406 | 44,9 | 81.235 | 40.994 | 50,46 |
| Totali | 223.486 | 99.051 | 44,3 | 205.350 | 93.187 | 45,37 |

000/leke

Pa dashur te justifikojme mosrealizimin, jo te gjitha taksat vendore kane patur te njejtin nivel realizimi dhe konkretisht:

- a. Taksa per biznesin eshte realizuar ne masen 79 %;
- b. Taksa e zenies hapesirave publike eshte realizuar 78 %;
- c. Taksa e tatimit te thjeshtuar te fitimit me agjent tatimor Drejtorine Rajonale te Taksave eshte realizuar ne masen 90 % .

Nje nga taksat me te rendesishme te vitit konsiderohet taksa mbi pasurine (ndertesat), e cila u realize ne masen 64% per sektorin e biznesit.


Ndersa krahasuar me vitin 2013, nga kjo takse u mblodhen 8.473.000 leke me shume. Krejt ndryshe paraqitet niveli i realizimit te kesaj takse per familjaret, e cila u realizu vetem 17%. Pra, akoma nuk kemi krijuar traditen ne komunitetin qytetar se, kur te kerkohet sherbimin, duhet qe te japesh detyrimin ligjor.

Si nje nga taksat me te rendesishme te vitit konsiderohet taksa e ndikimit ne infrastrukture, e cila per aresyet qe trajtuam me lart ne tre vitet e fundit ka ardhur gjithnje ne renje.

Te dhenat paraqiten nepermes tabelës se meposhteme dhe grafikut:

000/l


| Taksa ndikimit ne infrastrukture | 2012 | | | 2013 | | | 2014 | | |
|----------------------------------|--------|--------|------|--------|--------|-------|--------|-------|-------|
| | Pl. | F. | % | Pl. | F | % | Pl. | F. | % |
| | 69.000 | 18.506 | 26,8 | 70.000 | 23.489 | 33,55 | 60.000 | 8.106 | 13,51 |



Ky grafik tregon se gjate viteve 2012, 2013 ,dhe sidomos ne vitin 2014 kemi patur renje te dukshme.

Edhe te ardhurat **jotatimore** kane patur realizime te ndryshme ne tarifa te ndryshme, nder te cilat evidentojme:

- Tarifa e sherbimeve te biznesit eshte realizuar ne masen - 92 % etj.
- Tarifa e pastrimit nga institucionet eshte realizuar ne masen - 70 %.
- Ndersa tarifa e pastrimit nga familjaret eshte realizuar vetem - 17 %,



Detyra akoma me te medha dalin, perpara kesaj drejtorie, per realizimin e te ardhurave per vitin 2015.

DREJTORIA E FINANCES - ka patur si objekt:

1. Ndjekjen e vazhdueshme te gjendjes financiare dhe ushtrimin e kompetencave te saj, per rritjen e efektivitetit ekonomik dhe financiar.
2. Zbatimin e nje politike financiare me objekt, per te balancuar shpenzimet administrative ne raport me te ardhurat;
3. Ndjekjen ne menyre permanente te situates ekonomike dhe tendenca, per ndryshime te mundeshme ne buxhetin e vitit, per te ruajtur ekuilibrat financiare etj.

Gjate vitit 2014, baze per financimet buxhetore kane qene;

- a. Fondet e krijuara nga te ardhurat e realizuara nga taksat e tarifate;
- b. Grandi i pakushtezuar i planifikuar nga qeveria,
- c. Fondet e qeverise per zhvillimin e rajoneve dhe fonde te tjera me destinacion te caktuar nga digasteret dhe,
- d. Kredia e disbursuar.

Cilet kane qene treguesit financiar të vitit 2014 :

- Te ardhura nga taksat dhe tarifate vendore, ne vleren **93.187 mije** leke ose 45,37 %, ndaj planifikimit. (realizimi 92 milion e 329 mije leke)
- Grandi pakushtezuar, 78 milion e 588 mije leke;
- Te ardhurat e pa perdorura nga viti 2013 ne vleren 4 525 mije leke;
- Kredia bankare nga disbursimi 42 milion e 607 mije leke.
- Diferenca nga donatore dhe burime tjera.

Me kete buxhet jane financuar pagat, shpenzimet dhe investimet gjate vitit 2014.

Ndersa shpenzimet e vitit 2014 kane keto tregues:

- **Fondi i pagave** – eshte realizuar ne masen 98 perqind, ose 1 milion e 350 mije leke me pak nga plani;
- **Shpenzime operative** – ne masen 92 % ose 72.451 mije leke te realizuara nga 78.751 mije lekë te planifikuara;
- **Investimet** – u realizuan ne masen 50 %, ose 59.565 mije leke, ndaj 119.150 mije leke te planifikuara;
- **Sherbime te kontraktuara** – u realizuan ne masen 68,46 %, ose 24.501 mije leke, nga 35.785 mije leke te planifikuara;
- **Shpenzimet buxhetore** ne total, per vitin 2014, u realizuan 59,5 %, ose nga 371.222 mije leke te planifikuara, u realizuan ne masen 220.911 leke .

Viti 2014, ishte jo vetem viti i projekteve te shumta te cilet do e transformojne qytetin, por edhe nje vit i veshtire nga ana financiare. Mosrealizimi i te ardhurave te buxhetit, kane ndikuar negativisht ne financimin e shpenzimeve dhe sherbimeve. Por, nuk leme

pa permundur kujdesin e vecante qe eshte treguar per mbajtjen nen kontrollin te shpenzimeve, per te ruajtur balancimin e te ardhurave me shpenzimet.

Pra, ndonese keto dy paragrafe, trajtojne mosrealizime ne te ardhurat e vitit 2014, puna e drejtorise se finances, ka vleresimin e saj. Kjo e lidhur me punen gjithevjete qe ben stafi i kesaj drejtore, kujdesi ne kontrollin dhe menaxhimin e buxhetit te Bashkise dhe disiplina administrative mjaft korekte e stafit te saj.

DREJTORIA E MIREQENES SOCIALE DHE RINISE:

Si nje nga strukturat me te ndjeshme, e cila menaxhon problemet me te mprehta sociale dhe fondet qe jepen ne ndihme te familjeve dhe individeve ne nevoje, ka patur arritjet e saj.

Duke qene nje strukture ligjore dhe vleresuese, per vitin 2014 ka patur disa objeksione te rendesishme nder te cilet evidentojme:

1. Studimin me objektivitet te familjeve ne nevojë dhe personave me aftësi të kufizuar, per t'i ofruar ndihmën e nevojshme ekonomike e shërbimin social brenda kuadrit ligjor.
2. Bashkëpunimi me institucione homologe, për hartimin e projekteve sociale, ne ndihme te familjeve ne nevoje dhe personave vulnerabel.
3. Eshte punuar me OJF, per hartimin e projekteve per kualifikimin e pjestareve te familjeve qe trajtohen me ndihme ekonomike, per te mundesuar punesimin dhe shkurtimin e skemes se pageses papunesise.
4. Puna me kontigjentin e grave te dhunuara, me femije te braktisur, me organizata rinore dhe te moshes se trete, kane qene ne fokusin e objeksioneve te kesaj drejtorie gjate vitit 2014.

Nder sektoret qe ka menaxhuar kjo drejtori evidentojme:

Spektori i ndihmes ekonomike, si sektori me i ndjeshem, ne te cilin harmonizohet ligji, pa cenuar vleresimin real te gjendjes ekonomike te familjeve ne nevoje. Gjate ketij vleresimi nuk ka munguar si perfshirja ne skemen e ndihmes te familjeve te reja ashtu edhe pastrimin e saj nga familje dhe persona qe nuk kane patur mbeshtetje ligjore, per t'u trajtuar me ndihme ekonomike. Objekti kryesor ne politiken sociale ka qene dhe mbetet rritja e punesimit dhe ulja e numrit te familjeve qe trajtohen me ndihme ekonomike.

Megjithate evidentojme faktin se gjate vitit 2014 jane trajtuar mesatarisht 500 familje me ndihme ekonomike, nder te cilat rreth 80 % e tyre jane trajtuar me ndihme te plote.

Ndersa krahasuar me dy vite me pare numri i familjeve te trajtuara me ndihme ekonomike ka qene me tendence zbritje. Ky eshte nje objektiv i politikës sociale te

geverise, per te rritur punesimin dhe ulur numrin e familjeve qe marrin pagese papunesie, kjo verehet edhe nepermes tabelës krahasuese.


| Nr. mesatar i familjeve te trajtuara me ndihme ekonomike | Sipas viteve | | | | | |
|--|--------------|------------|-------|------------|-------|------------|
| | 2012 | | 2013 | | 2014 | |
| | Numri | Vlera/lek | Numri | Vlera/lek | Numri | Vlera/lek |
| | 546 | 26.986.100 | 548 | 26.755.800 | 500 | 23.467.600 |

Ndersa **Sektori i Perkujdesjes Sociale** ka patur si objekt pune :

- Evidentimin e subjekteve qe perfitojne perkujdesje sociale dhe menaxhimin e fondit akorduar per kete kategori shoqerore, ndjekjen e problemeve sociale qe kane te bejne me dhunen ne familje, barazine gjinore, te drejtat e komuniteteve dhe te femijeve etj.

Numri i personave te trajtuar gjate vitit 2014 te krahasuar nder vite ka qene me tendence rritje. Kjo per arsyeen e ardhjes se familjeve nga rrethet e zones verilindore me persona me aftesi te kufizuar ose invalid pune, kjo e shprehur ne tabelen qe vijon :

| Emertimi | Te trajtuar sipas viteve | | |
|---------------------|--------------------------|------------|--------------|
| | 2012 | 2013 | 2014 |
| Persona te trajtuar | 837 | 886 | 1.091 |






Personat e trajtuar gjate vitit 2014 nga muaji janar-dhjetor 2014 eshte sipas tabelës :

| Emertimi | Persona me aftesi kufizuar | Shuman e lek | Invalid pune | Shuma ne lek |
|--------------------|----------------------------|--------------|--------------|--------------|
| Nr. mesatar | 540 | 79.654.250 | 551 | 20.765.100 |

Fondi i akorduar nga shteti, per kete kontigjent me aftesi te kufizuar rezulton rreth 13% me e larte se ne vitin 2013, e shprehur sipas tabelës:

| Persona me aftesi te kufizuar dhe invalid pune. | Vitet | | |
|---|--------|--------|---------|
| | 2012 | 2013 | 2014 |
| Fondi akorduar 000/lek | 82 750 | 88.589 | 101.713 |

000/leke





Stafi i drejtorise mireqenjes sociale dhe rinise, ka ndjekur mbarevajtjen e punes ne sektorin e rinise, te drejtave te femijeve, mbeshtetjen ndaj grave te dhunuara per barazi gjinore, qendren e zhvillimit ditor dhe ate te moshes se trete.

Eshte per tu permendur mbeshtetja qe jep qendra “Shenjtja Mari” perfaqesuar nga misionari Luciano Levri cili ka arritur te grupoje dhe t’i heqe nga rruga 188 fëmijë të komunitetit Rom & Egjiptian duke i integruar në arsimin e detyruar (9-vjeçar) në qytetin e Lezhës.

Ne saje te perkujdesjes dhe bashkepunimit institucional jane arrit disa tregues social, per komunitetin Rom & Egjiptian, nder te cilet evidentojme:

- Jane trajtuar me programe sociale 13 familje duke i paguar qirane e baneses;
- Jane riparuar 36 banesa te komunitetit Rom dhe Egjiptian, me financim nga MZHU&T;
- Kete vit shkollor jane rregjistruar 18 fëmijë të ketyre komuniteteve në sistemin parashkollor;
- Shoqatat Rome & Egjiptiane jane mbështet në organizimin e aktiviteteve kulturore e artistike ne raste festash;
- 30 familjeve të komuniteti Rom dhe Egjiptian eshte dhënë asistencë për vetdeklarimet e banesave të tyre pranë ALUIZN-it.

DREJTORIA PLANIFIKIMIT TERRITORIT dhe INVESTIMEVE PUBLIKE:

Ka patur si objektiv :

1. Hartimin dhe menaxhimin e projekteve per investimet publike , e ndjekja e tyre, deri ne realizimin perfundimtar te tyre.
2. Krijimin e nje standarti te larte, te komunikimit me publikun, degjimi me interes i problemeve dhe mbeshtetja ne zgjidhjen ligjore.

3. Kryerjen e detyrimeve ndaj investitoreve privat si ne aspektin e dhenies se ndihmes teknike dhe ne mbledhjen e dokumentacionit per per miratim.
4. Bashkepunimin institucional me institucione vendore, per marrjen e konfirmimeve zyrtare ne interes te zgjidhjes se ankesave dhe kerkesave te komunitetit.
5. Sistemimin e dokumentacionit te ardhur nga institucionet dhe sektorit privat, dhe krijimin e arkives se urbanistikes.


Si jane realizuar objektivat ?.

- Sektori i projektimit, gjate vitit 2014 ka perballuar punen me te madhe ne shtate vitet e fundit, duke hartuar e vene ne zbatim **12 projekte** te reja, e hartuar e dorezuar tek donatoret edhe **11 projekte** te tjera per vitin 2015. *Per realizimin e ketyre projekteve jane bere inspektime dhe kontrole ne terren , duke bere nje analize te hollesishme te gjendjes egzistuese te infrastruktures , jane marre foto, eshte kontrolluar faza e punimeve (per punimet qe kane filluar dhe jane ne vazhdim e siper).*
Pastaj ne zyre jane ripunuar me programet perkatese dhe jane derguar ne menyre elektronike dhe shkresore tek donatori (FZSH). Emertimi i te cileve eshte dhene ne fillim te materialit te analizes.
- Sektori i kadastres urbane, ka punuar per plotesimin dhe dorezimim per regjistrim te 320 aseteve te bashkise;
- Jane pergatitur dhe publikuar ne programin e “Sistemit per Kerkesat dhe Ankesat” te Zyres me Nje Ndalese, listat e dokumentave ligjore e teknik, qe duhen plotesuar per te aplikuar per leje te ndryshme ndertimi;
- Jane ndjekur investimet me fondet e Bashksie dhe hartuar disa preventiva punimesh, per investimet e reja dhe rikonstruksione ne infrastrukturen publike ne qytet;
- Eshte ndjekur korespondenca me institucione shteterore dhe investitor privat, per zgjidhjen e kerkesave dhe ankesave te komunitetit;
- Jane ushtruar kontrole e mbajtur aktet perkatese, per te gjitha objektet (e pajisura me leje ndertimi) qe jane ne ndertim e siper, sipas fazave te ndertimit.
- Eshte shqyrtuar e arshivuar dokumentacioni teknik e juridik i kerkesave te reja per sheshe e leje ndertimi.
- Jane paisur te gjithë investittoret me Leje Perdorimi (shfrytëzimi), për objektet qe kane plotësuar detyrimet ligjore sipas studimeve urbanistike dhe kerkesave te dhene ne lejet e zhvillimit.
- Por, krahas punes dhe arritjeve te vitit 2014, ne aspektin e realizimet te treguesve financiar te planifikuara si te ardhura, nga ndikimi ne

infrastruktura, nuk janë realizuar. Kjo nuk ka qenë pasojë e mangësive të punës tonë, por si rrjedhojë e mungësës së trojeve të reja, pamundësisë paguese e investitoreve që kanë paraqitur kërkesën për leje zhvillimi dhe ndërprerja për pjesën më të madhe të vitit të drejtës, për dhenje leje për ndertime të reja. Treguesit e mosrealizimit janë dhënë në pjesën ku analizohet realizimi i të ardhurave për vitin 2014, të cilat janë sipas tabelës së mëposhtme:

000/l

| Taksa ndikimit ne infrastrukture | 2012 | | | 2013 | | | 2014 | | |
|----------------------------------|--------|--------|------|--------|--------|-------|---------------|--------------|--------------|
| | Pl. | F. | % | Pl. | F. | % | Pl. | F. | % |
| | 69.000 | 18.506 | 26,8 | 70.000 | 23.489 | 33,55 | 60.000 | 8.106 | 13,51 |



Si objektiv kryesor, për vitin 2015 kemi :

1. Realizimin në kohë dhe me cilësi të projekteve të filluara në vitin 2014;
2. Ndjekjen e procedurave dhe detyrimet tona ligjore e teknike, për fillimin e projekteve të reja parashikuar për vitin 2015;
3. Hartimin e projekteve të reja, për infrastrukturën publike, për investimet që do miratohen në buxhetin e vitit 2015.

DREJTORIA E SHERBIMEVE PUBLIKE:

Nje nga sektoret me te evidentuar nga komuniteti, per vete funksion qe kryen dhe raportin me qytetarin.

Aktiviteti i kesaj drejtorie eshte i monitoruar nga vete qytetaret dhe mund te konsiderohet si pasqyre e drejtimit dhe kultures sherbimit qe bashkia i ofron banoreve te saj.

Si e tille per vitin 2014 ka patur si objektiv :

Rritjen e cilesise se sherbimit ndaj qytetareve, ne te gjitha llojet e sherbimeve qe ofron. Bashkia si :

- Sherbimin e pastrimit dhe menaxhimin e mbetjeve urbane;
- Perimiresimin e gjelberimit dhe shtimin e fondit të gjelbërt në qytet dhe kurorën përreth tij;
- Mirëmbajtjen e institucioneve publike, rrjetin rrugor dhe sinjalistikën, ndriçimin, sistemin e kanalizimeve etj.;
- Krijimin e raporteve te partneritet me komunitetin qytetar, per realizimin e pritmerive qe ata kane, per nje qytet te paster, te gjelberuar e me vlere turistike.

Nder treguesit vitit 2014 sipas sektoreve evidentojmei:

- a. **Spektori i pastrimit:** si sherbimi me i ndjeshem, per komunitetin, ne vitin 2014 ka gjetur shtrirje ne gjithe qytetin, kjo fale permiresimit te infrastruktures rrugore dhe asfaltimi i tyre, duke e shtrire kete sherbim si ne bllokun 11,2 ha lagjen Beslidhja, ne lagjen "Nene Tereza", ne rrugen e Kalase etj.

Aktualisht kemi :

- 20 pika grumbullimi me shume se nje vit me pare;
- Kemi 170 kontenjere, per grumbullimin e mbetjeve urbane;
- Shtrirja e projektit per grumbullimin e diferencuar te mbetjeve urbane funksionon ne 40 pika te sherbimi ne gjithe zonen A;
- Ne funksion te sensibilizimit dhe ndergjegjesimit per ndarjen e mbeturinave ne burim dhe rritjen e kultures se pastrimit dhe ndergjegjesimit qytetar ndaj ketij sherbimi ne vitin e kaluar jane shperndare 120 kosha te vegjel plastike te gjitha institucionet e arsmit;
- Ne, duke qene bashki Pilot ne shkalle vendi, per menaxhimin e diferencuar te mbetjeve urbane, njesia jone krahas partneritetit disa vjecar me dldp-ne dhe Institutin e Zhvillimit Urban, ne vitin 2014 jemi perfshire edhe ne projektin e Qeverise Japoneze, per menaxhimin e mbetjeve urbane.

Por, krahas punes per permiresimin e cilesise se sherbimit jane verejtur edhe probleme te cilat jane ndeshur kryesisht ne periferi te qytetit dhe kryesisht:

- ne mjediset ku kufizohemi me komunat Kolsh, Shengjin dhe Balldre;
- ne gjatesine e kanalit tek rruga Shtraus, I cili sjell uje dhe mbetje nga perroj i Manatise, mjedis i cili na krijon imazh negativ, sa here qe krijohet ndotje;
- tek kanali i ujrave te larta ne lagjen e Spitalit, prurjet e te cilit kane bllokuar here pas here grykederdhjen qe vijon ne kanalin e mbuluar I cili kalon perballe varrezave te Deshmoreve,
- raste sporadike te ndotjes jane verejtur edhe ne disa blloqe banimi, ku investimi eshte ne proces apo infrastruktura nuk eshte ne nivelin e duhur.
- me gjithë masat organizative qe ka marre kompania e pastrimit ne bashkepunim me biznesin, diferencimi i mbetjeve urbane ne burim nga komuniteti qytetar, akoma len per te deshruar.

Sherbimi i gjelberimit i vleresuar si mushkerite e qytetit, ka patur vleresimin e duhur nga siper marrja “Floral” gjate vitit 2014 dhe konkretisht :

- Ky sherbim realizohet ne 90 560 m2 siperfaqe e gjelbert, ose rreth 15 mije m2 me shume se ne vitin 2013;
- Eshte punuar ne shtimin e siperfaqeve te gjelberta dhe ne permiresimin e bimesise dekorative ne te gjithë akset e rrugeve te qytetit. Aktualisht kemi rreth 1400 bime dekorative drurore te te gjitha llojeve qe nga Pisha e bute, Palma, Kumbulla e Kuqe, Blini etj.
- Vemendja kryesore gjate vitit 2014 nga drejtoria e sherbimeve ne bashkepunim me siper marrjen e gjelbrimit eshte kushtuar rritjes se cilesise se sherbimeve ne siperfaqet e gjelberta, ne perdorimi e teknikave te krasitjen e bimeve drurore dhe shkurre dekorative, per rritjen e performances se ketij sektori.
- Ndonese mungon sistemi i vaditjes, siper marrja e gjelberimit, duke shfrytezuar mjetet e thjeshta te vaditjes dhe kushtet e motit te vitit te kaluar, siguroj nje tapet gjithëvjeter te gjelbert.

Si nje nga sektoret e rendesishem ne mbrojtje te komunitetit, eshte vleresuar -

Sektori sherbimit veterinar dhe mbrojtjes se konsumatorit :

Dy specialistet e ketij sektori, me pervojen shume vjecare dhe detyrimin ligjor ndaj konsumatorit, kane ushtruar kontrole te perditeshme ne te gjitha pikat e tregetimit te produkteve shtazore dhe peshkut. Si rezultat I nje kerkese te vazhdueshme ky sector rezulton te kryej sherbimin ndaj komunitetit konforme te gjithë rregullave higjeno-sanitare, si nga kontrolli I origjines se produktit, paisjet per mbajtjen e tij dhe dokumentacionin ligjor.

Sektori i mjedisit strehimit dhe emergjencave civile; ka patur si objekt mbajtjen nen kontroll te situates mjedisore ne qytet, pranimin e kerkesave te qytetareve, per strehim dhe menaxhimin e situatave emergjente te cilat vitin e kaluar kane qene mjaft shqetesues edhe ne pikun me te nxehte te vitit si ajo e muajit korrik 2014.

Nga ky sektor eshte bashkepunuar me medi-at lokale ne drejtim te sensibilizimit te opinionit qytetar per mbajtjen paster te mjedisit nga inertet, ndersa me Policine Bashkiake eshte punuar per ndalimin e levizjes se kafsheve ne hapesirat publike.

Sektori i sherbimeve, ka qene ne funksion te mirembajtjes se institucioneve dhe infrastruktures publike ne qytet.

Nga ky sector mundesohet riparimi dhe mirembajtja e 13 objekteve te institucioneve, te arsimit, kultures, mirembajtja rreth 150 mije m² rruge e trotuare, 450 shtylla ndricimi ne akset rrugore dhe mjedisete publike ne blloqet e banimit, sinjalistiken rrugore etj.

Me kete sektor gjate vitit te kaluar jane kryer te gjitha sherbimet e domosdoshme te parashikuara ne objektet shkollore te qytetit ne kohen e duhur, duke bere te mundur qe ne cdo shkolle te filloje mesimin ne kushte normale.

Fondi i vene ne dispozicion per blerje baze material, per kete sector ka qene rreth 2 milion leke te reja, ose rreth dyfiah i fondit te vitit 2013. Ndonese ky fond ka patur rritje, nevojat per material te ndrtyshme ndertimi kane akoma me te medha. Kjo shpjegohet me amortizimin e pervitshem kryesisht te mjedisese shkollore. Mbase eshte e pa besueshme te thuhet, se perqindja me e madhe e materialeve te ndertimit shkon, per riparimin e shkollave duke filluar nga xhami, dyer, dritare, tavolina e karrige. Amortizimi i paisjeve ne shkolla eshte aq i madh sa nuk perballohet me ato material qe ne planifikojme. Ky fakt duhet vleresuar me shume nga drejtorite e shkollave dhe gjithe stafet pedagogjike, per te treguar kujdes me te madh per mirembajtjen e paisjeve ne shkolla.

Sherbimi i Varrimit eshte jane realizuar me sipermarje private.

Ky sherbim ka perballuar kerkesat e komunitetit ne raste fatkeqesish. Gjithashtu nga sipermarria e ketij sherbimi eshte synuar, jo vetem mirembajtja e mjedisese ne varrezat e Deshmoreve dhe ata Publike, por edhe ne perballimin e kerkesave te komunitetit per varre, ne nje mjedis thuajse te mbyllur. Kjo dukuri eshte perballuar duke shfrytezuar maksimalisht zonat e lira dhe rrugekalimet brenda territorit te varrezave.

Kujdesi i deritanishem, nuk e shmang vemendjen tone, per gjetjen e rrugeve te ndryshme shteterore ose private, per zgjerimin e siperfaqes se varrezave.

DREJTORIA JURIDIKE & PROKURIMEVE PUBLIKE :

Ka patur si objektiv :

1. Te ndikoje ne zbatimin e ligjshmerise ne praktiken e vendimmarrjes te Keshillit Bashkise dhe akteve administrative te nxjerra nga Kryetari i Bashkise, ne sherbimin ndaj komunitetit dhe gjithe veprimtarine administrative te bashkise.
2. Te asistoj drejtorite dhe sektoret ne hartimin e akteve administrative qe dergohen per miratim tek Kryetari i Bashkise dhe Keshillin Bashkiak;

3. Ne dhenjen e ndihmes juridike te gjitha drejtorive dhe sektoreve juridiksionin te bashkise, ne menyre te vecante te personelit te ri ne detyre;
4. Zgjidhjen e kerkesave dhe ankesave te qytetareve, brenda kuadrit ligjor dhe kompetencave, qe disponon njesia vendore;
5. Organizimi i punes per prokurimet publike, me qellim realizimin e procedurave ne kohe dhe ne perputhje me legjislacionin ne fuqi;

Stafi I kesaj drejtorie gjate vitit 2014 ka realizuar **keto detyra:**

1. Jane pranuar dhe menaxhuar dokumentacioni i 81 familjeve, per rregjistrimin e banesave te ndertuara para vitit 1990, ne zbatim te VKM nr. 608 date 05.09.2012, prej te cileve dokumentacioni 23 banesave eshte derguar per regjistrim ne ZVRPP-se.
2. Eshte plotesuar dokumentacioni per shpronese per nevoja publike, per ,,,,,,,, subjekte fizike, te cilet parashikohen te shpronesehen per aksin e rruges lagje "Nene Tereza" dhe jane ne proces edhedosje per shpronese ne bregun e lumit Drin.
3. Jane hartuar te gjitha kontratat shtese ne fillim te vitit, per te perballuar nevojat per ushqime dhe materiale te tjera per te mundesuar mbarvajtjen e institucionit deri ne miratimin e buxhetit te vitit 2014;
4. Eshte pergatitur dokumentacioni, per 5 prokurime sherbmi dhe blerje materiale ushqimore, lende ndertimi dhe karburant.
5. Eshte hartuar dokumentacioni i tenderave, per zhvillimin e 11 prokurimeve per pune publike, kryesisht me fonde te akorduara nga Qeveria, ministrite e linjes dhe te ardhurat e Bashkise;
6. Eshte hartuar dokumentacioni dhe jane zhvilluar 11 prokurime, per sherbimin e Mbikqyrjes dhe Kolaudimit te investimeve publike.
7. Jane ndjekur 12 ceshtje civile ne Gjykate, ku Bashkia eshte padites, pale e paditur ose pale e trete.
8. Eshte plotesuar dokumentacioni ligjor dhe derguar ne institucionet qendrore, per privatizim te aseteve te bashkise,

DREJTORIA PROGRAMIM - ZHVILLIMIT.

Ka patur si objektiv te vitit:

- a. Bashkepunimin me drejtorite dhe institucionet vartese, per evidentimin dhe perpunimin e indikatorëve te zhvillimit social-ekonomik, per hartimin e Strategjise Zhvillimit;
- b. Bashkëpunimin me donator vendase e të huaja si fondacione dhe shoqata, te cilat shprehin interes, per te bashkepunuar ose investuar ne territorin e Bashkise;

- c. Harmonizimi i strategjise se zhvillimit te qytetit tone me strategjite e zhvillimit rajonal dhe ate kombetare, ne perputhje me standartet europiane.
- d. Pergatitja dhe afishimi i materialeve promocionale, ne te cilat pasqyrohet puna dhe aktiviteti permanent i Bashkise;
- e. Azhornimi i faqes se internetit dhe mirembajtja e logjistikes elektronike te aparatit;

Disa nga detyrat e realizuara nga kjo drejtori:

1. Eshte hartuar Strategjia Zhvillimin 2013-2030, ne harmoni me strategjine rajonale e kombetare, ne perputhje me standartet europiane dhe botuar ne dy gjuhe.
2. Jane hartuar indikatore-t e zhvillimit, per te percaktuar drejtimet dhe prioritetet e zhvillimit;
3. Eshte hartuar dhe miratuar Strategjia anti-korrupsion per Bashkine Lezhe;
4. Eshte hartuar Plani i Veprimit, per Integrimin e komunitetit Rom & Egjiptian;
5. Jane evidentuar aktivitetet e zhvilluara ne Bashki dhe afishimi ne faqen zyrtare te Bashkise (Web, FB & Newslwetter);
6. Jane ndjekur maredhenjet e parneritetit te Bashkise ne nivel kombetar dhe nderkombetar;
7. Jane hartuar dhe hedhur ne sistem 18 projekte ne periudhen janar-nentor 2014;
8. Jane ndjekur procedurat dhe axhenda-t e vizitave te personaliteteve te huaja qe kane vizituar Bashkine Lezhe, si ambasador, perfaqesues te organiztave nderkombetare, bankave private, fondacioneve etj.
9. Eshte hartuar Plani Lokal i Veprimit per komunitetin Rom, per vitet 2013-2015;
- 10 Eshte vene ne funksionim sipas te gjitha standarteve bashkekohore Zyra me Nje Ndalse (Z1N) duke instaluar **Modul-et** kerkese-ankese, ndihmes ekonomike perfshire dhe permiresimet, per tu pershtatur kerkesat e cdo dokumenti zyrtar hyres dhe dales ne Bashkine Lezhe.
10. Eshte vene ne funksion dhe po azhornohet cdo dite faqja e re internetit.

Problemi i evidentuar: Mbledhja e te dhenave statistikore, dhe indikatoret e zhvillimit, per evidencat e vitit, behen me shume vonese nga mosvleresimi i drejtuesve, punojesve dhe institucioneve qe kane per detyre t'i perpunojne dhe dorezojne ne menyre periodike ne drejtorine e Programim – Zhvillimit.

DREJTORIA E ARSIMIT, KULTURES, TURIZMIT & SPORTIT:

Gjate vitit 2014 Ka synuar te realizoje keto objektiva:

1. Të mundesoje krijimin e raporteve te partneriteti me strukturat e arsimit, per krijimin e kushteve optimale, ne zhvillimin e procesit mesimor, faktor kryesor për rritjen e cilësisë në sektorin e arsimit;
2. Ne veprimtarite kulturore eshte synuar ne rritjen e nivelit te veprimtrive kulturor e artistike. Kjo nepermes bashkëpunimit te stafit te pallatit Kultures, me grupet amatore dhe individe te talentuar ne fushen e artit dhe kultures.
3. Ne funksion te rritjes se nivelit cilesor te sportit, te mbeshteten te gjitha ekipet sportive, duke filluar nga moshat e reja deri tek te rriturit, si ne ekipet e grup moshave ne futboll, shumesportet perfshire edhe volejbollin e femrave si nje risi per sportin ne qytetin tone.

Cili ka gene niveli i realizimit detyrave:

Stafi i kesaj drejtorie ne bashkepunim me drejtuesit e shkollave, me punonjesit e institucioneve te kultures dhe sportit, gjate vitit 2014, kane bere perpjekjet maksimale, per permbushjen e detyrave funksionale, per harmonizimin e sektoreve te arsimit dhe kultures, si per mbarevajtjen e punes ne shkolla dhe per te patur nje jete kulturore e sportive gjithëvjetore ne funksion te komunitetit.


Nder angazhimet kryesore mund te evidentojme:

Ne sektorin e arsimit, per te mundesuar rritjen e cilesise ne procesin mesimor eshte synuar ne permiresimin e godinave te shkollave, akomodimin e tyre me paisje-orendi dhe mjete didaktike, ne funksion te mesimit.

Aktualisht ne arsimin 9 vjecar **publik** dhe jopublik kemi keto te dhena:

- Ne **arsimin 9-vjeçar publik kemi 5 shkolla**, nga te cilat dy te reja, nje e rikonstruktuar, nje ne rikonstrukcion dhe vetem nje shkolle e cila ka nevojë per nderhyrje ne te ardhmen e afert. Ne kete kategori arsimit frekuentojne **2.788 nxenes**;
- Ne ate **jo publike jane 3 shkolla**, ne te cilat frekuentojne **585 nxenes**.

| Arsimi 9 vjecar: | Arsimi publik | | | Arsimi jopublik | | |
|------------------|---------------|--------|----|-----------------|--------|----|
| | shkolla | nxenes | % | shkolla | nxenes | % |
| | 5 | 2.788 | 79 | 3 | 585 | 21 |




Ne arsimin e **mesem publik kemi 2 shkolla**, njera nga te cilat e ndertuar para tre viteve, ndersa tjetra ka nevoje per rikonstruksion. Ne kete kategori frekuentojne **1.449 nxenes**

Ndersa ne arsimin **jo publik kemi 2 shkolla te mesme me 380 nxenes dhe, 3 shkolla 9 vjecare** jo publike, ne te cilat frekuentojne **585 nxenes**.


Raporti i frekuentimit ne shkolla publike, ndaj atyre jo publike eshte **82 % ne shkolla publike ndaj 18 % ne ata jo publike**.

| Arsimi mesem: | Arsimi publik | | | Arsimi jopublik | | |
|---------------|---------------|--------|----|-----------------|--------|----|
| | shkolla | nxenes | % | shkolla | nxenes | % |
| | 2 | 1449 | 74 | 2 | 380 | 26 |



Ne arsimin parashkollor kemi 7 kopshte, **5 publik dhe 2 jopublik** ne te ciletr frekuentojne **810 femije** nga te cilet **304 ne kopshte me ushqim**, ne te cilet punojne **74 edukatore**.

| Arsimi parashkollor | publik | | | jopublik | | |
|---------------------|---------|-------------|------|----------|--------------|------|
| | kopshte | frekuntojne | % | kopshte | frekuentojne | % |
| | 5 | 495 | 68 % | 2 | 239 | 32 % |



Sic rezulton nga te dhenat e mesiperme, arsimi publik ne tre ciklet e tij eshte dominant, ndaj edhe pergjegjesia e bashkise per mbarevajtjen e tij eshte e madhe. Ndonese ne si njesi vendore, ne bashkepunim me Drejtorine Arsimore dhe drejtuesit e shkollave, kemi patur vemendjen maksimale ne kete sektor, viti 2014, nuk kaloj pa veshtiresi qe tashme jane te njohura dhe konkretisht:

- Shkolla e mesme profesioanle e parashikuar per rikonstruksion me fonde te BE, e cila pritej te fillonte, mbase edhe te perfundonte rikonstruksioni ose ndertimi saj, akoma nuk ka filluar as sot e kesaj dite;
- Qe ne fillimin e vitit 2014 u perballeme me djegjen e paisjeve te nje grupi ne kopshtin e lagjes Gurra;
- Shkolla 9 vjecare Gj. Fishta, per aresye rikonstruksioni, na diktoj kalimin e nxenesve ne turnin e dyte tek ish godina e gjimnazit te vjeter, se bashku me shkollen e mesme profesioanle.
- Amortizimi i kopshtit me ushqim ne qender te qytetit dhe mungesa e hapësirave per zhvillimin normal te mesimit ne kete institucion, na imponon shembjen e tij, per ndertimin e nje kopshti te ri.

Keto shtate na detyruan qe kete vit shkollor, te kemi nje shkolle ne turnin, dyte dhe kopshti me ushqim te akomodohej ne mjediset e konviktit te shkolles profesioanle.

Shpresojme qe ne vitin 2015 te kemi tjetër performance dhe kushte mesimi, ne objekte te reja dhe te rikonstruktura.

Nje mjedis i rendesishem, per Bashkine ka qene Konvikti i shkollës së mesme profesionale, i cili ka funksionuar vetëm për 23-36 vajza, per vete hapësirat qe jane lene ketij konvikti, nga zenja e nje kati me Qendren e Zhvillimit Ditor.

Ndonese me nje aktivitet te pjesshem, ky institucion ka funksionuar shume mire, fale investimit te bere vite me pare, kujdesit te treguar nga kontigjenti i vajzave, nga perkujdesi i stafit drejtues dhe punonjesve te tij.

Sektori i **kultures** ka patur si objektiv permbushjen e detyres ne aspektin e veprimtarive kulturore, artistike, historike, si pjese e programimit vjetor. Mbase viti 2014 ka qene i vecante, pasi perkoj me 70 vjetorin e clirimit te atdheut.

Nder veprimtarite kryesore te institucioneve te kultures evidentojme :

Pallati i Kultures si institucioni kryesor i kultures ne qytet, per vitin 2014 ka realizuar 75 veprimtari ose mesatarisht 6 veprimtari ne muaj si dhe jane ekspozuar rreth 325 vepra arti, nga artist te te gjitha moshave. Krahas veprimtarive te zhvilluara ne mjediset e ketij pallati (salla shfaqjeve, galeria arteve dhe salla e leksioneve), nje numer i konsiderueshem veprimtarish jane zhvilluar ne mjedise te tjera duke filluar nga mjediset e qytetit si Kalaja Mesjetare, Memoriali, Obelisku, ne njesite vendore te rrethit si Shengjin e Blinisht, per te vijuar ne Mirdite e Shkoder, ne Prishtine dhe ne ditet e Lezhes ne Kline te Kosoves. Ne traditen tone kulturore veprimtarite kulturore dhe historike fillojne me 17 janar te cdo viti, per tu mbyllur ne naten festive te vitit te Ri.

Biblioteka si institucioni me i konsoliduar i kultures ne qytet, ka patur nje game te gjere aktivitetesh, si ne sherbim te banoreve dhe ne aspektin e promovimit, veprimtarive jubilarë dhe historike, shkencore dhe kulturore.

Gjatë vitit 2014 ne kete institucion jane kryer me mijera sherbime ndaj lexuesit (33.000), kane frekuentuar rreth 8500 lexues, jane zhvilluar 39 veprimtari kulturore, veprimtari jubilarë dhe historike.

Ne kete institucion eshte punuar edhe ne drejtim te paisjes me botime te reja dhe akomodimin, per te rritur cilesine e afishimit dhe ruajtjes se fondit te librit.

Si ne gjithë veprimtarine e qeverisjes elektroinike te Bashkise edhe Biblioteka po punon, per dixhitalizimin e fondit te librit, per te rritur cilene e sherbimit, kontrollin dhe ruajtjen e fondit te librit.

Sektori i **Muzeut dhe Memorialit**, e fillon vitin kulturor me 17 janar, dite ne te cilen perkujtohet Heroi yne Kombetar.

Edhe ky institucion ka treguar kujdes te vecante ne perkujtimin e ngjarjeve historike te popullit tone, kryesisht ata te luftes, si dhe jane perkujtuar figura historike te periudhes se Rilindjes si Hafiz Ali Ulqinaku, si personalitet i shquar i kultures, arsimit dhe klerik.

Mjediset e institucioni, jane frekuentuar nga personalite te artit e kultures, diplomat dhe figura te shquara te politikës shqiptare dhe europiane. Ne Memorial dhe mjediset rreth tij, jane organizuar nje sere veprimtarish kulturore, festive dhe promovuese.

Nje nga sektoret me kryesor te veprimtarise se punes shume vjecare te Bashkise, duke e konsideruar si nje nga shtyllat e zhvillimit ekonomik te banoreve te qytetit tone

eshte vleresuar sektori I **Turizmit**. Te gjitha investimet qe jane ne process dhe ata qe do vijojne do kene si objekt shtimin e vlerave historike dhe kulturore te qytetit te Lezhes, per ta bere me atraktiv dhe te vizitueshem, nga visitor venas dhe te huaj.

Me personelin tone te cultures e turizimit dhe nepermes projekteve te financuara nga BE, me vizita ne Memorial dhe promovimet qe jane bere ne disa vende te europes dhe ne Kosove, kemi synuar ne kopletimin e "Pasaportes" tone turistike.

Keshtu mund te permendim projektin **Adristorical Lands**, me finanicme te BE i cili krijoi mundesi qe Lezha dhe kultura e saj te jete pjese e axhendes se mjaft gazetareve dhe mediave te rendesishme te europes.

Botimi I hartave fletëpalosjeve, broshurave të ndryshme, dokumentave turistike per vizitoret dhe hapja e nje pike promovimi ne afersi te mereve antike, ka rritur interesimin nga visitor te vendeve te ndryshme. Nje pune e kujdeshme eshte bere gjate vitit 2014 edhe ne aspektin e bashkepunimit dhe partneritetit me kompanite dhe agjencite turistike te rajonit tone.

Sektori i Sportit, ka patur si objekt rritjen e cilesise sportive ne 6 lloje sportesh (*futboll, mundje, xhudo, karate, volejball (femra) & boks*) ne te cilin funksionojne 16 ekipe te moshave te ndryshme.

Aktualisht jemi ne nje faze shprese, per kalimin ne ligen superiore ne futboll, jemi klasifikuar në tre vendet e nderit në kategorinë e pare, per sportin tradicional te mundjes; kemi shenuar rezultate te mira me 3 ekipe në Xhudo-s, dhe performance te mire ne Volejball për femra.

Krahas ekipeve te rinje dhe te rritur janë të ngritura dhe funksionojnë ekipet e moshave 10-13 vjeçare para të rinje të cilët gjatë kësaj periudhe kanë marrë pjesë në aktivitete kombëtare dhe janë dalluar për performancën e tyre.

DREJTORIA BURIMEVE NJEREZORE:

Ka synuar :


1. Ne rritjen e vazhdueshme te nivelit dhe cilesise se punes se administrates, ne aspektin e kryerjes se detyres funksionale dhe rritjen e pergjegjesise ne sherbimin ndaj komunitetit;
2. Ne implementimin e praktikave te reja, ne qeverisjen elektronike dhe persosjen e kamunikimit me qytetarin, nga te gjitha zyrat e ne menyre te vecante nga stafi Zyres me Nje eNdalese (Z1N - One Stop Shop).
3. Kualifikimin e personelit dhe ofrimin e administratës së bashkisë me politikat lokale e rajonale, evidentimin e problemeve te komunitetit dhe venja ne rrugen e zgjidhjes te kerkesave dhe ankesave te ngritura nga ana tyre;
4. Krijimin e kushteve normale te punonjesve te aparatit te Bashkise dhe institucioneve vartese, per te mundesuar veprimtarine normale te tyre.

5. Prezantimin ne media te arritjeve dhe problemeve qe jane evidentuar ne punen e Bashkise , insititucioneve te tjera publike, ne interes te komunitetit lezhjan.

Nder detyrat qe ka ndjekur kjo drejtori evidentojme :

- Venjen ne eficence te plote te Zyres me Nje Ndalese (One Stop Shop), per te rritur cilesine e sherbimit ndaj qytetarit dhe shkurtimin e kohes se pergjigjes, ndaj kerkesave dhe ankesave te tyre. Per funksionimin e kesaj zyre jane trajnuar 15 punonjes te administrates, per te sherbyer Non Stop nga ora 08:00 deri ne 16:00 te cdo dite.
- Rritjen e nivelit te administrates ne aspektin profesioanl dhe administrativ, nepermes kualifikimit te organizuar dhe individual. Kjo eshte arritur nepermes bashkepunimit me institucioneve trajnuese te specializuara si; Instituti i Trajnimeve te Administrates Publike (ITAP), Partners Shqip, USAID; dldp etj.
- Eshte plotesuar struktura administrative, per te mundesuar realizimin e detyrave funksionale te cdo sektori.
- Eshte zbatuar ligji i Ri, “Per Nepunesin Civil” (152/2013) ne aspektin e konfirmimit te statusit nepunesit civil, ose te periudhes se proves. Niveli arsimor dhe profesioanl i administrates ne raport me vendin e punes, ka mundesuar faktin qe aktualisht 72 % e administrates bashkise sot, eshte me status nepunesi civil ose ne periudhe prove.

| Gjithsej administrata | Vende pune me status punesi | % | Nepunes civil & periudhe Prove | % | Nepunes me kontrate pune | % |
|-----------------------|-----------------------------|----|--------------------------------|----|--------------------------|----|
| 63 | 46 | 73 | 34 | 74 | 13 | 26 |





- Nga sektori i personelit jane kryer detyrat funksionale per plotesimin e dokumentacionit, per cdo punonjes te sherbimit civil ose me kontrate pune.

- Eshte ndjekur me perparesi cilesia e pergatitjes se materialeve per Keshillin e Bashkise, hartimi i P/Vendimeve dhe zbardhja e tyre ne kohe.
- Krahas dhjetëra kronikave televizive te dhena ne median lokale, nga sektori i media-s jane dhene rreth 200 kronika televizive ne televizionin publik shqiptar, ne te cilat eshte pasqyruar pshkise.
- Nga sektori i maredhenjeve me publikun jane organizuar pritje ditore me specialist dhe drejtoret dhe ata periodike me Kryetarin e Bashkise, per terheqjen e ankesave dhe kerkesave te qytetareve te cilat kane patur si objekt, strehimin, punesimin, ndihmen ekonomike, sherbimet publike etj.
- Nga sektori i protokollit jane administruar 7495 shkresa nga te cilat 3027 te hyra dhe 4468 te prodhuara nga administrata e Bashkise.

Krahasuar nder vite jane sipas tabeles:

| Vitet | Shkresa | | Vertetime | Vendime/ Kryetarit | Urdhera/ kryetarit |
|------------------------|--------------|-----------|-------------|-----------------------|-----------------------|
| | Hyrje | Dalje | | | |
| 2012 | 2570 | 1920 | 2650 | 57 | 63 |
| 2013 | 2688 | 4475 | 2775 | 50 | 60 |
| 2014 | 3027 | 4468 | 2238 | 81 | 165 |
| <i>Krahasuar/ 2013</i> | + 339 | -7 | -537 | + 31 | + 105 |



Si konkluzion: Rritja numrit te akteve (vendime + urdhera) tregon, per nje angazhim me te madh dhe problematiken qe ka patur administrata gjate vitit 2014. Ndersa renja e numrit te vertetimeve, lidhet me perdorimin e kartes identitetit ne mjaft procedura administrative nga qytetaret.

SEKTORI AUDITIT:

Njesia e auditimit ka funksionuar në nivel sektori, për vitin 2014 e cila ka realizuar 12 auditime nga të cilat:

- a. auditime te plota 2 (dy),
- b. auditime të perputhshmerise ligjore 3 (tre);
- c. të përfomances 2 (dy);
- d. auditime financiare 5 (tre).

Njësia e auditimit të brendshem ka plotesuar misionin e saj, duke qene njekohesisht bashkëpunuese me të gjithë sektoret e zyrat e aparatit.

Të gjitha auditimet janë kryer me grup pune, ku përveç punonjësit të sektorit janë mobilizuar edhe specialistë të zgjedhur brenda aparatit në vartësi të auditimit të kryer. Në realizimin e misioneve të auditimit janë dhene 26 rekomandime për masa organizative, te cilet jane realizuar 23 prej tyre, ndersa 3 rekomandime janë në process realizimi.

Njekohesisht në bashkëpunim me drejtorine e Finances në zbatim të rekomandimeve te KLSH-se u arrit që të lidhen kontratat me disa subjekte përdoruese të aseteve të bashkisë, për rrjedhojë u realizuan rreth 2.3 milion lekë të ardhura.

Spektori i auditimit ka realizuar një bashkëpunim të frytshem me Drejtorine e Finances duke realizuar kontrole të vazhdueshem në çdo hallkë të veprimtarisë ekonomiko-financiare.

Për vitin 2015 sektori auditimit do të punojë për rritjen e cilësisë së auditimit, do te ndjek me pergjegjesi rekomandimet e dhena do punoje, për realizimin e puneve komunitare dhe përmiresimin e jetes së komunitetit qytetar.

INSPEKTORIATI NDERTIMOR URBANISTIK

Ka patur si mision ushtrimin e përgjegjësivë ne kontrollin e territorit, zbatimin e standarteve në fushën e ndërtimit ne zbatim te ligjit “Për Inspektimin e Ndërtimit” dhe akteve nenligjore ne zbatim te tij.

Veprimtaria e ketij sektori gjate vitit 2014 ka synuar :

1. Ne evidentimin dhe marrjen e masave për parandalimin e ndërtimeve të paligjshme në territorin administrativ të Bashkisë.

2. Ne kontrollin e plotë dhe efektiv te subjekteve ndërtuese ne investimet publike dhe ato private, përmbajtjen e dokumentacionit tekniko-ligjor gjate zbatimit te projekteve.
3. Te njihet me projektet e investimeve, evidentim i objekteve që pengojne investimet si dhe kryerjen e procedurave ligjore, për lirimin e shesheve të ndërtimit.
4. Kontrollin dhe evidentim i objekteve të vendosura në zonën e Parkut Arkeologjik kryesisht në zonën A. Kryerja e procedurave ligjore dhe Ekzekutimi i prishjeve.
5. Ndjekje dhe trajtimi i mënjëhershëm I ankesave të subjekteve fizike e juridike (qytetarëve), për problemet që shqetesojne ne fushen e ndertimeve pa leje.
6. Bashkëpunim me sektorët e tjerë të Bashkisë dhe institucioneve shtetereore si, Drejtoria Planifikimit Territorit, Policia Bashkise, Policia e Shtetit etj., për të rritur efikasitetin e punës.
7. Ndjekja me seriozitet I trajnimeve që jane organizuar ne Bashki dhe INUK për ngritjen profesionale të stafit të INUV-it të Bashkisë

Gjate vitit 2014 eshte evidentuar kjo pune inspektoriatit ndertimor urbanistik:

- janë mbajtur 51 akte konstatimi për ligjshmërin e ndërtimit;
- janë dhene 7 vendime pezullim punimesh;
- Jane dhene 34 vendime prishje;
- Janë bere 2 prishje ndertimesh;

POLICIA BASHKIAKE

Ne përberje te se ciles kane ushtruar kompetencen e tyre ligjore 6 polic dhe nje inspektor policie, me nje mision te rendesishem ne Bashki, si institucion i zbatimit te akteve administrative dhe mbeshtetje ne te gjithë praktikat ligjore.

Nder detyrat kryesore te realizuara gjate vitit 2014 evidentojme :

- Kryerja e sherbimeve ne funksion te ruajtjes se rendit, qetesise dhe mbarevajtjes se jetes ne qytet;
- Zbatimin e akteve te nxjerra nga Kryetari dhe Keshilli i Bashkise, si per rendin, qetesine, sigurimin e te ardhurave vendore, lirimin e mjedisve publike etj.
- Respektimin e dispozitave ligjore, te cilat rregullojne veprimtarine e tregetimit e sherbimit ne mjedise publike;
- Parandalimin e ndotjeve te mjedisit nga subjekte private apo publike dhe marrjen e masave per vendosjen e situatave normale ne qytet;
- Zbatimin e kerkesave te Kodit Rrugor ne parkimin e automjeteve ne qytet dhe jashte vendeve te miratuara nga bashkia etj.

Nje nga detyrat me te rendesishme te Policise Bashkiake gjate vitit 2014 ka qene mbeshtetja ndaj drejtorise Taksave Vendore, per realizimin e te ardhurave vendore, ne funksion te se ciles jane **zbatuar 86 urdhera** per bllokim aktiviteti.

Ne mbeshtetje te Inspektoriatit Ndertimor, per pezullimin e ndertimeve te paligjshme dhe prishjen e objekteve qe jane bere pengese, per zbatimin e investimeve publike. Ne menyre te vecante eshte punuar, per kontrollin e lirimin e hapësirave publike. Gjate ushtrimit te detyres jane vendosur **19 gjobave** me nje vlere prej **90.000 leke** te arketuara.

Por krahas angazhimeve jane verejtur edhe veshtiresi ne kryerjen e detyres dhe konkretisht :

1. Me gjithë bashkepunimin me policine rrugore, per stabilizimin e trafikut, per vete kushtet dhe hapësirat e kufizuara te qytetit, ne periudhen e veres, ka patur mjaft veshtiresi ne mbajtjen nen kontroll te ketij sektori.
2. Disiplina e punes dhe kultura e sherbimit nga personeli I policies, jo gjithnje ka qene ne lartesine e duhur, me normat e cultures dhe kodin e etikes.

GJENDJA CIVILE (institucion i deleguar)

Prane Bashkise Lezhe ushtron aktivitetin e saj edhe Zyra e Gjendjes civile e cila per vitin 2014 ka dhene asistence dhe administruar 322 kerkesa , prej te cilave -128 kane qene per tu bere banore te qytetit, -176 ndarje trangu familjar dhe -18 bashkime familjare.

Gjithshtur Zyra e Gjendjes civile per vitin 2014 ka regjistruar:

- 231 akte lindje
- 140 akte martese
- 98 akte vdekje

Ne batim te Dekretit Presidentoit dhe ligjit zgjedhor, ne muajin dhjetor te ketij viti jane bëre verifikimin e shtetasve te dubluar brënda dhe jashte njesise se Gjendjes Civile.

Per vitin 2015 kjo zyre ka prioritet hartimin e listave paraprake dhe perfundimtare te shtetasve per zgjedhjet vendore dhe sqarimin e informimin e tyre ne lidhje me qendrat e votimit.

Disa nga objektivat e vitit 2015:

1. Ne aspektin e rritjes se cilesise se sherbimit ndaj qytetarit, do synojme:
 - a. Ne dixhitalizimin e plote te veprimtarise se administrates bashkise dhe vazhdimin e punes si njesi Pilot, per zgjerimin e kesaj platforme edhe ne njesite tjera vendore;
 - b. Ne rritjen e kultures dhe profesionalizmit, ne sherbimin ndaj komunitetit, duke filluar nga marrja e ankesave dhe kerkesave te qytetareve, venja ne rrugen e zgjidhjes ligjore, ne nje kohe sa me te shkurter.

3. Ne zbatim te legjislacionit dhe praktikave me te mira, ne pergjedhjen e personelit nepermes konkurimit, kualifikimin dhe akomodimit me paisjet e nevojshme, per t'i sherbyer komunitetit me kompetence profesionale dhe ligjore;
4. Ne permiresimin e sherbimeve baze si, ate te pastrimit, gjelberimit dhe mirembajtjes se infrastruktures publike, nder te cilat evidentojme:
 - a. Shtrirjen e sherbimit te pastrimit ne te gjitha rruget e qytetit, duke filluar nga rruga lagje "Nene Tereza", ne bllokun 11,2 ha lagje "Beslidhja", ne rrugen e Spitalit etj.
 - b. Zgjerimi i pikave te mbledhjes se diferencuar te mbetjeve urbane, duke perfshire edhe blloqet e banimit, ne te cilat jane asfaltuar rruget dhe permiresuar infrastrukture e tyre;
 - c. Perfshirja aktive ne projektet e dldp dhe qeverise Japoneze, per ndergjegjesimin e komunitetit qe mbetjet te ndahen qe ne burim.
 - d. Ne sektorin e gjelberimit te ndryshojme metodologjine e deritanishme, per te mundesuar modele te reja dhe bashkekohore, te mjediseve te gjelberuara dhe bimesise me cilesore.
5. Ne sektorin e arsimit te synojme ne krijimin e mjediseve te reja te akomoduara, dhe te paisura me mjete didaktike bashkekohore.
6. Sektori i kultures do punoje ne funksion te rritjes se cilesise se aktiviteteve artistike dhe ato te kultures dhe per nje shtrirje gjithvjetore te veprimtarive,
7. Ne drejtim te permiresimit te infrastruktures dhe jetes se qytetareve do synojme te permbushim ne kohe dhe cilesisht mire investimet e filluara ne vitin 2014 dhe fillimin e punimeve ne **11 projekte te reja si :**

Investimet e vitit 2015:

Grupi parë:

1. Rikonstrukcion i bllokut 11,2 ha, *–faza e katert –* lagje "Beslidhja",

- *Gjendja aktuale.*



-*Projekti per zbatim.*



2. Rikonstruktion dhe sistemim rruge pas stadiumit;



3. Rikonstruktion rruge lagje SMT:



4. Rikonstruktion i rruges “ Shtraus’



5. Rehabilitimi i “Shetitores se lumit Drin”



Grupi dytë:

6. Rikonstruktion rruge lagje Gurra (A);



7. Rikonstruktion rruge Spitalit – lagje Gurra (B);

8. Rikonstruktion blloku banimi pas Katedrales:

- Gjendja aktuale.



-Projekti per zbatim





9.Rikonstruksion blloku 11.2 ha;



1. Rikonstruksion rruge Spitalit – lagje Gurra;



10. Rikonstrukcion asfaltim rruges varrezave- lagje "Nene Tereza":





Grupi dytë:





2. Rehabilitimi i “Shetitores se lumit Drin”



Grupi dytë:

3. Rikonstruktion rruge lagje Gurra (A);



2. Rikonstruktion rruge – lagje “Gurra” (B)



4. Rikonstruktion rruge Spitalit – lagje Gurra (faze e dyte);



5. Rikonstruksion blloku banimi pas katedrales



6.

7.

8. Rikonstruksion blloku banimi pas katedrales



9. Rikonstrukcion blloku 1.2 ha;



10. Rikonstrukcion asfaltim rruges varrezave- lagje Kodermarlekaj

Te nderuar pjesëmarres !

Permes kesaj analize kemi sjellë ne vemendjen tuaj, momentet me te rendesishme te punes se administrates Bashkise per vitin 2014.

Evidentimi i mangesive dhe percaktimi i rrugeve me efikase, per shmangjen e tyre gjate vitit 2015 eshte transparence dhe besueshmeri, per ndryshime cilesore ne permbushjne e detyrimeve ligjore dhe administrative qe bashkia ka ndaj komunitetit te saj dhe grup moshave te qytetareve.

Viti 2015, jo vetem perkon me fundin e mandatit katervjecar 2011-2015 te qeverisjes vendore, por eshte viti zgjedhor i cili do krijoje nje konfigurim te ri ne administrimin e pushtetit vendor, duke marre permasa te reja me shtrirje territoriale, zgjerim ne menaxhimin e burimeve njerezore dhe problematike me te gjere se deri tani, ndaj kerkohet:

- Nje vizioni te ri per integrimin e te gjithe territorit e Bashkise se re ne projektet e zhvillimit vjetor e perspektiv.

- Hartimin dhe implementimi e projekteve ambicioze, per zhvillimin e qytetit dhe permiresimin e cilesise se jetese se banoreve te te gjitha treves se Lezhes;
- Nepermes praktikave te reja si Zyra me Nje Ndalese (Z1N- One Stop Shop), te permiresojme, cilesine e sherbimit ndaj komunitetit, duke shtrire praktiken e qeverisjes elektronike ne te gjitha minibashkite e rrethit;
- Vazhdimi i tradites se ketyre viteve, ne rikonstruksionin e objekteve te arsimit, per t'i krijuar mundesi te plota arsimimi dhe zhvillimi brezit te Ri;
- Zgjerimi dhe permiresimin e mjediseve sportive ne shkolla dhe ne klubin sportiv, ne sherbim te masivizimit dhe rritjes se cilesise sportive;
- Krijimin e nje atmosfere besimi tek gjithë banoret, se administrata e Bashkise eshte gjithnje ne sherbimin te tyre, ne perpjekje te vazhdueshme per te permiresuar kushtet e jetes ne te gjitha aspektet dhe ne sherbim te te gjitha moshave.

Duke perfunduar, Ju siguroj se administrata e Bashkise do jete gjithnje ne sherbimin te komunitetit, ne perpjekje te vazhdueshme per te permiresuar kushtet e jetes te banoreve tane ne te gjitha aspektet dhe ne sherbim te te gjitha moshave.

Faleminderit per vemendjen.

VIKTOR TUSHAJ
Kryetari i Bashkise

Grupi parë:

11.Rikonstruksion i bllokut 11,2 ha, –faza e katert – lagje “Beslidhja”



12.Rikonstruksion dhe sistemim rruge pas stadiumit;

13.Rikonstruksion rruge lagje SMT



14.Rikonstruksion i rruges “ Shtraus’



15.Rehabilitimi i “Shetitores se lumit Drin”



Grupi dytë:

16.

17.Rikonstrukcion rruge lagje Gurra (A);



18.Rikonstruksion rruge lagje Gurra (B);

19.Rikonstruksion blloku banimi pas katedrales





20.Rikonstruksion blloku 11.2 ha;

21.Rikonstruksion rruge Spitalit – lagje Gurra;



22.Rikonstruktion asfaltim rruges varrezave- lagje Kodermarleka



